

Thirrje publike nr. 01/102015

1. Furnizues

1.1. Furnizues: Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë

2. Lënda e furnizimit

2.1. Shërbime për mirëmbajtje të vazhdueshme të higjienës (detajet janë dhënë në specifikacion).

2.2. Lënda e furnizimit nuk është e ndashme.

2.3. Thirrja është publike, me të drejte për pjesëmarrje të të gjithë personave juridik të regjistruar për veprimtarinë e cila është lëndë e furnizimit.

3. Përmbajtja e ofertës

3.1. Oferta duhet të përmbajë: emër, adresë, selia e ofertuesit, numri i xhirollogarisë, numri tatimor dhe banka deponuese;

3.2. Oferta duhet të përmbajë edhe kontrollin e cilësisë së shërbimeve dhe çmimet e shërbimeve;

3.3. Oferta duhet të plotësohet në formularin e shpallur në ueb faqen e Universitetit;

3.4. Në qofte se si ofertues paraqitet person juridik i huaj, oferta duhet të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe ose gjuhën maqedonase, ndërsa çmimi mund të paraqitet me valutë tjetër (konvertibile) e cila llogaritet sipas listës së valutës të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (kursi i mesëm) i cili aplikohet në ditën e hapjes së ofertave;

3.5. Oferta duhet të ketë afat prej 90 ditësh.

4. Dokumentacion me të cilin ofertuesi dëshmon gjendjen ekonomike dhe financiare

- Dokument për veprimtari të regjistruar si dëshmi se është i regjistruar si person juridik për kryerjen e veprimtarisë lidhur me lëndën e thirrjes publike, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Leje nga organi kompetent për punë (veprimtari) për operatorë ekonomik;

- Dokument për bonitet i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi;

- Vërtetim se nuk është hapur procedurë për likuidim;

- Vërtetim për sanksion kundërvajtës - ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së veçantë;

- Vërtetim nga Drejtoria për të hyra publike për tatime të paguara, kontribute dhe detyrime të tjera;

- Deklaratë se në 5 vitet e fundit nuk është kumtuar aktgjykim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizata kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje të parave;

Raport auditimi për vitin e fundit kalendarik.

Dokumentet e lartpërmendura nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj, ndërsa dorëzohen në original ose kopje të vërtetuar nga operatori ekonomik.

Personi juridik ose fizik i huaj i dorëzon dokumentet e lartpërmendura të lëshuara nga institucione përkatëse të huaja.

Dokumentet tjera të lëshuara nga institucionet përkatëse nga vendi i huaj dhe në gjuhë të huaj duhet të jete i përkthyer në gjuhën maqedonase ose gjuhën shqipe dhe i vërtetuar nga përkthyes gjyqësor.

Ofertat të cilat nuk do t'i përmbajnë dokumentet e lartpërmendura do të llogariten si të pakompletuara dhe të njejtat nuk do të shqyrtohen.

5. Dokumente me të cilat ofertuesi dëshmon aftësinë teknike ose profesionale

- Listë e shërbimeve të kryera për të cilin dorëzohet ofertë, të kryera në vitet e fundit, me vlera, data dhe shfrytëzuesit (listë referuese) sipas kushteve nga dokumentacioni i tenderit;

- Vërtetim nga shfrytëzues i shërbimeve për tre vitet e fundit për përshtatshmërinë, kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit nga ofertuesi.

6. Kriteret për zgjedhjen e ofertës më të përshtatshme:

- Cilësi;
- Çmim;
- Referenca;
- Mënyra dhe afati i pagesës;

Në bazë të kriterëve të lartpërmendura zgjidhet oferta më e përshtatshme.

7. Mënyra dhe afati i dorëzimit të ofertave

Ofertuesi duhet ta dorëzojë ofertën në një kopje origjinale në zarf të mbyllur, në të cilën duhet të jete shenja „Mos e hap”, të jetë e firmosur nga ana e përgjegjës të ofertuesit. Në zarfën e mbyllur duhet të ketë edhe dy zarfa tjera, të mbyllura. Njëra nga zarfat e mbyllura e përmban ofertën, me shenjën „Oferta”, ndërsa zarfi tjetër përmban dokumentacionin e nevojshëm, me shenjën „Dokumentacioni”, në të cilën duhet të jetë edhe adresa e saktë e ofertuesit.

Ofertat të cilat nuk i përmbajnë të gjitha të dhënat të kërkuara në thirrjen, gjegjësisht në të cilat nuk është bashkangjitur dokumentacioni i kërkuar do të llogariten si të pakompletuara dhe nuk do të shqyrtohen.

Afati për dorëzimin e ofertave është deri më 28.10.2015, ora 16:00

Ofertat të cilat do të dorëzohen pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Ofertat mund të dorëzohen nëpërmjet postës në adresën: Universiteti i Evropës Juglindore, bul. „Ilindenska” numër 335, 1200 Tetovë ose të dorëzohen në arkivin e Universitetit të EJT, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Detaje tjera lidhur me thirrjen publike mund të merrni nëpërmjet e-mailit: procurement@seeu.edu.mk

8. Dispozitat përfundimtare

Ofertat e dorëzuara pas kalimit të afatit dhe të cilat nuk janë të përgatitura sipas thirrjes publike nuk do të shqyrtohen.